

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 874/20
 Datë/Datum. 02.11.20

PRISHTINË - PRISTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr i prokurimit	62500-20-5915-1-2-1
Nr i brendshëm	62500/20/140/121

Sa i përket tenderit për: **FURNIZIM ME MJETE KONKRETIZIMI - PAISJE PËR KABINET TË SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME TË KOMUNËS SË MALISHEVËS**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

INFINITT SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.28 Nentori, no.121

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

044/974-590

(Numri Telefonit)

10.000

(Kodi postar)

/

(Numri i Faks-it)

Astrit Uka- menaxher

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë)

Infinit.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

30.10.2020.

(Data e parashtrimit të ankesës)

REPUBLIKA E KOSOVËS
 INFINITT SH.P.K
 (Nënshkrimi dhe vula)

* Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 01.10.2020.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertav: 12.10.2020.

Dta dhe ora e hapjes së ofertav: 12.10.2020. ora 14:30

Njoftimi mbi vendimin e AK: 15.10.2020.

Kriter për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me cmimin me të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Procesverbalin e hapjes se ofertave e kemi pranuar ne e-prokurim.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Letren standarde per tenderuesin e eliminuar se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK i kemi pranuar ne e-prokurim me 15.10.2020.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesen per ri-shqyrtim te AK kemi dorezuar me 20.10.2020.

Njoftimi per pezullimin e aktivitetit te prokurimit 20.10.2020.

Vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar 21.10.2020.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve

Neni 60- Kriteret per dhenie te kontrates

Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 39 i UOPP-se Sqarimi i tendereve

Neni 41 i UOPP-se Ekzaminimi, veresimi dhe krahasimi i tendereve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet



Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Këto terme janë përdorur shumë herë në tekstin e mëposhtëm prandaj edhe i kemi përdorur shkurtetat që kanë domethënie si në vijim:

AK- Autoritet Kontraktues

OE- Operator Ekonomik

FDT- Fleta e të dhënave të tenderit

LPP- Ligji i prokurimit publik

UOPP- Udhëzimi operativ për prokurim publik

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 12.10. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe letrat standarde për OE ofertues, kompania jone eshte eliminuar me arsyetimin:

Ju eliminoheni për arsyeje se- ju mungojne deshmite se keni perfunduar me sukses kontrata te natyres se njeite ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontrate te realizuara minimumi ne vere prej 80,000.00euro. Ne baze te nenit 72 dhe 59 te LPP-se Lista e kontratave te realizuara e dorezuar nuk permbush kerkesat minimale te vleres se percaktuar nga AK. Refuzohet tenderi pa kerkuar informata te metutjeshme.

Konstatimi i AK/komisionit vleresues eshte i paqendrueshem dhe jo-ligjor, kompania jone ka dorezuar listen e projekteve te realizuara ne 3 vitet e fundit/ listen gjenerale ku jane te paraqitura dhjetera projekte te natyres se njeite me kete aktivitet te prokurimit.

Nga lista e kontratave e dorezuar ne kete projekt, kontratat me nr rendor ne liste: 2, 8, 24, 29, 30, 31, 36, 38, 39, 40, 50, 52, 53, 54, 62, 64, 75

Jane kontrata te natyres se njeite me kete aktivitet te prokurimit dhe nese nxjerrim totalin e tyre arrin vleren 1,160.039,⁸²€. Furnizime te realizuara ne 3 vitet e fundit para publikimit te njoftimit per kontrate per kete projekt.

AK duke u thirrur ne nenin 72.3 te LPP-se dhe nenin 39 te UOPP-se ka mundur te kerkoje sqarime shtese lidhur me kontratat e natyres se njeite te cekura ne liste.

Citoj nenin 72.3 te LPP-se:

-Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

AK para se te vendos per eliminimin e kompanise sone eshte dashur te veproj konform LPP dhe UOPP duke u thirrur ne dispozitat ligjore te lartecakura te kerkoje sqarime shtese nga kompania jone per kontratat e natyres se njeite te cekura ne liste.

Bashkangjitur me kerkese per ri-shqyrtim i kemi dorezuar AK deshmite per realizimin e kontratave te cekura ne liste mirepo AK nuk i ka mar parasysh dhe nuk ka ri-vleresuar aktivitetin e prokurimit.



9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve të lartcekura nga AK/komisioni vlerësues ka ardhur deri të eliminimi i kompanise sone pa të drejte dhe njekohesisht na është pamundësuar fitimi i nje kontrate publike.

Kompanise sone i është mohuar nje fitim simbolik i paramenduar nga kjo kontrate dhe është demtuar buxheti i shtetit perkatesisht KK Malisheve per 3436.50euro.

Kerkojme nga organi shqyrtues i prokurimit qe te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar, lenda te kthehet ne ri-vleresim dhe konform nenit 72.3 te LPP-se dhe nenit 39 te UOPP-se AK te kerkoje sqarime shtese te datajshme lidhur me kontratat e cekura ne liste.

Kerkojme qe ankesa te aprovohet si e bazuar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

